VENDIM
Nr.90, datë 10.2.2010

PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË REJA TË STUDIMIT, PRANË SHKOLLËS SË LARTË PRIVATE "EPOKA", TIRANË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 2, 43, 44 e 45 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen, në shkollën e lartë private "Epoka", Tiranë, të programit të studimit të ciklit të dytë, në formën e studimeve me kohë të plotë, në "Inxhinieri ndërtimi" me profilet:

a) "Inxhinieri e strukturave të ndërtimit";

b) "Menaxhim i ndërtimeve".

2. Ky program studimi i ciklit të dytë realizohet me 120 kredite dhe kohëzgjatja normale e tij është 2 (dy) vite akademike. Në përfundim të programit të studimit lëshohet diplomë e nivelit të dytë (DND), në "Inxhinieri ndërtimi" me profilet:

a) "Inxhinieri e strukturave të ndërtimit";

b) "Menaxhim i ndërtimeve".

3. Hapjen në shkollën e lartë private "Epoka", Tiranë, të programit të studimit të ciklit të tretë, "Master i nivelit të dytë (MND)", në formën e studimeve me kohë të plotë, në "Inxhinieri ndërtimi".

4. Ky program studimi i ciklit të tretë realizohet me 60 kredite dhe kohëzgjatja normale e tij është 1 (një) vit akademik. Në përfundim të programit të studimit lëshohet diplomë "Master i nivelit të dytë (MND), në inxhinieri ndërtimi".

5. Shkolla e lartë private "Epoka", Tiranë të fillojë veprimtarinë mësimore për programet e studimit, të përcaktuara në pikat 1 e 3 të këtij vendimi, pasi të ketë marrë, jo më vonë se dy javë para fillimit të vitit akademik, lejen përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

6. Ky institucion duhet t'i nënshtrohet procesit të akreditimit institucional dhe të këtyre programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

7. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KYEMINISTRI
Sali Berisha